REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA KLOKOT / KOMUNA E KLLOKOTIT
Nr. 865/2 Dt. 18.06.2019
KLOKOT / KLLOKOT

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Komuna e Kllokot-Vrbovc/Opština Klokot-Vrbovac*

| | |
|---|---|
| **Vendi I takimit** | **Hapësirat e Kuvendit të komunës në Kllokot** |
| **Datë** | **31.05.2019** |

Në bazë të nenit 43.pika (43.1,43.2,43.3,43.4,43.5) Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale 03/L-040,si dhe statutit të komunës sipas nenit 18. Është mbajtur seanca e pestë e rregullt e Kuvendit komunal Kllokot-Vërbovc për vitin 2019,me rendin e ditës paraprakisht të bashkangjitur. Me atë rast është hartuar si vijon:

# PROCESVERBALI I PESTË I RREGULLT I SEANCËS SË KUVENDIT KOMUNAL KLLOKOT-VËRBOVC PËR VITIN 2019

Seancën e udhëheqi kryesuesi I Kuvendit komunal Kllokot-Vërbovc z.Zarko Dejanovic.

Në fillim kryesuesi përshëndeti të gjithë delegatët e pranishëm,qytetarëtmdrejtorët,përfaqësuesit e OSBE-së,nënkryetarin,zonjën Selvije Rexhepi dhe kryetarin e komunës.

Pas thirrjes u vërtetua që ekziston kuorum për punën e seancës.

**Anëtarët prezent 13**

**z.Kryesuesi**: A dëshiron dikush ndryshim apo plotësim të rendit të ditës? Pasi që askush nuk dëshiron e jap në votim rendin e ditës së sotme.

**Konstatoj se njëzërit u aprovua rendi I ditës me 13 vota për.**

Kalojmë në pikën e parë.

**1.Aprovimi I procesverbalit nga senaca e katërt e rregullt e kuvendit për vitin 2019.**

A dëshiron dikush të marr fjalën? Pasi askush nuk dëshiron,kush është për aprovimin e kësaj pike?

**Konstatoj se me shumicën prezent e aprovuam pikën e parë me 9 vota për.**

Kalojmë në pikën e dytë.

**2. Shqyrtimi dhe aprovimi I vendimit të kuvendit lidhur me Planin e Punës për siguri në komunitete( KKSK);**

**Z.Dragisa Kojic:**Mirëdita të gjithëve, dua ta informoj kuvendin për hartimin e planit të sigurisë, ku në një nga seancat kemi vendosur për të formuar një komision për këtë projekt. Komisioni ka bërë një draft që keni para jush. Komisioni u bazua në kuadrin ligjor që është aktualisht në fuqi për të hartuar këtë plan. Dokumenti i referohet udhëzimit administrativ 27/2012 MPB-së dhe 03/2012 të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, ku thekson krijimin e një plani për anëtarët e komitetit të sigurisë komunale dhe aktivitetet e tyre. Gjithashtu, kam përdorur komisionet e sigurisë në komunitet që janë në fuqi që nga viti 2011 deri në këtë vit.Kjo është një strategji e përdorur nga të gjitha komunat në territorin e Kosovës. Nga ky plan, ju mund të shihni se ka iniciativa të caktuara për projekte dhe aktivitete të ndryshme të zbatimit të tyre dhe llogaridhënies, kush është përgjegjës për veprimet e tyre.Ky plan do të zgjas 12 muaj. Në komision kanë marrë pjesë të gjithë përfaqësuesit e fshatrave ku kemi përfshirë projekte,siç janë vendosja e kamerave nëpër shkolla: Sveti Sava-Kllokot,Marko Rajkovic,shkolla e Muzikës- Vërbovc,Gjon Serreqi- Mogillë. Vendosja e rrethojave tek shkolla në Mogillë dhe Vërbovcë. Si edhe në të gjitha rrugët e kalueshme ka të bëjë me sigurinë në komunikacion ku ata janë ngushtuar për të kryer një zgjerim të dyfishtë për të shmangur aksidentet e trafikut.Si dhe zgjerimi i të gjitha urave në territorin e komunës tonë dhe disa projekte të tjera që ju keni në draft. Këto aktivitete duhet të zbatohen deri në vitin 2020, komisioni do të përcaktojë vlerësimin dhe a do të financohet nga buxheti ose nga ana e donatorëve.

**Kryesuesi :**Po e jap në votim kush është për aprovimin e kësaj pike?

**Konstatoj se me shumicë të pranishmëve e aprovuam pikën e dytë të rendit të ditës me 10 vota për,kurse 3 delegatë nuk u deklaruan.**

**3. Propozim-vendimi mbi transferimin e mjeteve financiare të investimeve kapitale nga një projekt në dy projekte tjera të planifikuara;**

**Z.Dragisa:**Ky projekt vjen nga kryetari I komunës,e keni marrë propozim vendimin dhe aty theksohet se nga do të merren mjetet e caktuara dhe ku duhet të transferohen. Kemi pasur një pagesë të detyrueshme nga Tafa petrol dhe atëkohë nga ai kod I projektit janë marrë mjetet e caktuara dhe për atë arsye projekti nuk është mundur të zbatohet në plotmëni dhe kanë mbetur mjete të caktuara në atë kod. Në mënyrë që t'I shfrytëzojmë mjete ai kod I projektit ,ne nga ju kërkojmë që gjithashtu projektet të cilat janë të planifikuara sipas planit të prokurimit dhe në përgjithësi sipas buxhetit për të cilat ekzistojnë edhe kodet në ministgri që ato mjete prej 28,000 € të bëhet bartja nga projekti asfaltimi I rrugëve nga të gjitha rrugët e pa asfaltuara në teritorin e komunës së Kllokotit në kodin e regjistruar rregullimi I puseve nëpër fshatin Vërbovc. Gjithashtu nga projekti I njejt të transferohen mjetet në vlerë 2500 euro në po ashtu projektin e regjistruar me titullin ndërtimi I urës në lumen e Zhitisë dhe rregullimi I hyrjës tek ura. Këto projekte janë planifikuar.

**Z.Hidajeti:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,lidhur me këtë pikë mendoj që transferi nga ky kod dhe kategoritë ekonomike do të ishte mirë të jetë në atë kod dhe të planifikohet ndonjë rrugë e caktur e cila nuk është e mbuluar apo e pa asfaltuar edhe në Kllokot edhe në Mogillë me sa di unë tri rrugë tek hyrja në Radivojc dhe rruga në Zhiti edhe ajo rruga Zakuta,mendoj që është shumë e nevojshme për qytetarët të cilët jetojnë në ato rrugë ndoshta nuk ka mjete të mjaftueshme mendoj se do të ishte mirë të bëhet planifikimi për këto rrugë të cilat I përmendamndoshta do të ishin të mjaftueshme mjetet për një rrugë që të punohet.

**Z .Kryetar:**Përshëndes të gjithë pranishmit,unë plotësisht pajtohem me Hidajetin që këto rrugë duhet të asfaltohen por ne kemi patur problem pasi që Tafa petrol me dhunë I kanë tërhequr mjetet pastaj unë kam insistuar që atë marrëveshje ta shtyejmë por edhe kam menduar që atë kontratë fare të mos e zbatoj por ndodhi ajo,ai që e ka fituar atë projekt ka ankesa ndaj komunës dhe ne duhet t'ia paguajm penallat,nëse na

padit duhet të paguajmë,unë vetëm se I kam siguruar mjetet për asfaltim të rrugëve kështu që ato nuk janë shumë e madhe 28 gjegjësisht 30 mijë euro të cilat ndahet për urën nuk do të thot shumë për asfaltim. Ne I kemi fituar disa mjete nga MAPL-ja në process janë bisedimet për shpalljen e tenderit ne këtë vit do ti asfaltojmë rrugët ku ka shqiptar ose drejt Radivojcit ose drejt Zhtisë. Por nëse na lejojnë kërkesën nga ministria e infrastrukturës atëher do ti asfaltojmë të gjitha rrugët. Prandaj po e cek që këto mjetet duhet ti bartim në mënyrë që ta përfundojmë këtë projekt në Vërbovc dhe Urën në lumin e Zhitisë. E me vetë këtë do të marrim mjete tjera për asfaltim të rugëve. Deri në fund të këtij viti nuk do të ketë rrugë të pa asfaltuara sepse unë vitin e ardhshëm do të ndaj edhe 200,000 euro për asfaltim të rrugëve nëse nuk naj miraton ministria për infrastrukturë. Unë po ju lus juve delegatëve që të barten mjetet nga ky kod  në kodin tjetër për ti ikur dënimeve gjyqsore.

**Z.Shqiprim:** Përshëndetje për të pranishmit,unë në seancat e kaluara kam kërkuar që të ndërtohen trotuare nga Mogilla deri në Vërbovc dhe te dalja nga Mogilla deri te Tafa petrol dhe më është vërtetuar se do të jet në projekt,dhe a mund të di se cfar po ndodh ?

**Zonja Selvije:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit,ne e kemi bërë një projekt për ndricim dhe trotuare. Projekti është gati ne kemi aplikuar në Unionin Evropian. Përveç trotuareve,për trotuarin I cili është në fshat ne veç jemi në process të projektit,deri më 10 qershor do të aplikojmë në një projekt në të cilin UNMIK-u n aka dhënë përkrahje të madhe. Vetëm t'i përgjigjem Shqiprimit ne po presim realizimin e këtij projekti të cilin e përmenda.

**Z.Naseri:** Përshëndetje për të gjithë,unë pajtohem me mendimin e kryetarit që të mos denohemi,dhe është shume e mirë që po diskutojmë për këto gjëra sepse mund të ndodh,dhe në vend që po punohet dicka tjetër. Ndaj mendimin se duhet se duhet të miratohet plotësisht, kam një kërkesë nga qytetarët që bëjnë presion të përditshëm për rrugën në hyrje të Radivojcës dhe Zitisë, sepse ata shohin drejtpërdrejt për ngjarjen që po bëhet në Vrbovac dhe Grncar. Ka disa punë të tjera që nuk janë me një sasi të madhe fondesh dhe se ata fillojnë të shohin se po bëhet diçka për ta. Qëllimi ynë është që ne të mos kemi kontradikta, keqkuptime dhe se të gjithë ti kemi prekur nga pak. E di që të gjitha rrugët do të asfaltohen, po ashtu edhe për projektin që kemi  biseduam dhe ku arritëm një marrëveshje për bashkëpunim me Likovën.Nuk e di deri ku ka arritur ajo ka qenë e sigurt që do të na ndihmojnë në pastrimin e lumenjëve. Për projektin e parë në shumën prej 220000 eurove na ka kaluar afati,kurse sa I përket projektit për turizëm nënkryetarja për komunitete ka qenë aty.

**Z.Selvije**: Unë do të ndërlidhem në atë që po i marrin fondet siç është rasti me Tafa petrollin,unë kam përvojë në financa mirë e that që duhet kushtuar vëmendje secila do palë e cila I drejtohet gjykatës,gjykata I merr fondet aty ku I gjen. Ashtu është edhe rasti me Tafa petrollin,sa I përket Likovës ne I kemi patur dy alternative: Turizmin dhe Pastrimin e Lumit. Tek pastrami I lumit vlera ka qenë 66 mijë euro dhe nuk e kemi caktuar për shkak se ka qenë vlera e vogël në krahasim me atë që e ka ofruar unioni evropian. Komuna e Likovës e ka ndryshuar sepse edhe ata kanë qenë për pastrimin e lumit. Të dy komunat e kemi bërë projektin për turizëm. Komuna e Kllokotitata po e shofin që është problematice të caktohet ajo. Ne kemi filluar me projektin nga qendra e deri tek Baja,e kemi bërë projektin me kanalizim,ndricim dhe rrugët,projekti kushton 97 mijë euro. Ata na kanë kërkuar që tu japim mjete. Kemi bërë projektin për trotuare nga Ura eDilit deri në Mogillë,nga Mogilla deri në Vërbovc. Lajmi I mirë është që mbulohen 150 mijë euro përafërsisht,ku komuna do të paguaj 15 % kurse kjo në total do të jetë 28 mijë euro. Ne e kemi përcjellur dhe kemi hyrë në astë listë dhe ajo është rreth 500 euro taani vetëm po presim që ata të na lajëmrojnë. Deri më datën 20 maj ka qenë koha për aplikim.Në këtë ekip unë nuk jam vetëm I ka edhe dy tre zyrtar të cilët do të jenë të informuar për të gjitha

dhe deri ku kemi arritur me komunën e Likovës. Do të dëshiroj që cdo gjë te jetë në rregull. Desha të falemderoj Bajën e Kllokotit e cila na ka I ka paguar dy projekte në shumën prej 140 mijë e dicka euro.

**Z.Naseri:**Unë vetëm dua ta përshëndes këtë punë të tillë,punën e mirë që po bëhet.

**Z.Kryetari:** Projektet e këtyre mjeteve, siç tha Naser, pajtohem me mendimin e tij, por mbi të gjitha po punojmë në projekte, duke punuar në faza. Unë mendoj se është shpallur një tender për ndriçim në komunën tonë,kun ë momentin kur të kaloj tenderi,njerëzit nga Zhitija gjegjësisht Ballanca do të fitojnë ndriçimin,po ashtu edhe asfaltimin e rrugëve. Po ashtu shkon projekti për mbudhjen e rrugëve të fushave. Kurse sa I përket pastrimit të lumit ne vetëm se jemi në bisedime ta fitojmë projektin,shpresoj se do të fillojmë më pastrim,nëse nuk ka mjete të mjaftueshme këtë vit do të vazhdojmë vitin tjetër. Mendoj se Sokoli e ka fituar projektin për pastrimin e shtarit të lumit. Ne kemi mjaft projkete bashkëpunimi me komunën e Vitisë dhe kur të realizohen të gjita këto projekte në komunë do të shihet përparim i dukshëm. Dëhiroj ta falemderoj zonjën Selvije për angazhimin e saj të jashtëzakonshëm dhe po të mos ishte ajo komuna e Kllokotit nuk do të fitonte shume projekte dhe disa vende punes,po ashtu edhe rreth projektit me Likovën dhe ne të gjithë të shkojnë në gjurmët e saj për të punuar sa më shumë që të jetë e mundur. Do të ndërlidhem tani me atë që e tha zotëri Naseri për Vërbovcin dhe Gërnqarin është e vërtetë se tani më shumë po punohet në atë pjesë,porn ë 8 vitet e kaluara atje asgjë nuk është punuar dhe në një mënyrë reale atje do të punohet por edhe në vendet e tjera që të jenë të kënaqur të gjithë.

**Kryesuesi :** Kush është për aprovimin e pikës së tretë?

**Konstatoj që me 8 vota Për e kemi aprovuar pikën e tretë një ka qenë I përmbajtur.**

**4. Propozim-vendimi mbi dhënjen e pëlqimit nga Kuvendi Komunal për zbatimin e procedurave ligjore mbi ndryshimin e destinacionit të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore në ngastrën numër : P-73701026-01088-0 në emër të pronarit Bekim Haziri ( Saqip) Zona Kadastrale Kllokot;**

**z.Drejtori Vlajkovic:** Përshëndes të pranishmit, zotërinjë delegatë siç e dini vitin e kaluar keni marrë një vendim për mbrojtjen e tokës bujqësore në këtë vendim qëndron që vetëm në raste të veçanta, me kërkesë të qytetarëve, kryetari mund të jap propozim vendim në kuvend. Kuvendi është ai i cili mund të jep pëlqim për ndrrimin e destinacionit nga ajo bujqësore tokë ndërtimore,në atë mënyrë qytetarët mund të fillojnë me procedurat para së gjithat me marrjen e lejimit nga departamenti për ndrrimin e destinacionit të pronës dhe si qëllim përfundimtar në këtë zinxhir të marrjes së një leje ndërtimi. E keni propozim vendimin e cila është dorëzuar nga ana e kryetarit dhe tek ju mbetet të vendosni se a do ta jepni pëlqimin mbi nisjen e procedurave gjegjësisht për të kthyer tokën bujqësore në tokë ndërtimore.

**z.Naseri:** Unë tani dua të sqarohem,ne atëhere kur kemi votuar për vendin ku duhet të bëhet ndrryshimi I destinacionit duhet të jetë 100m ndërmjet dy asfalteve,kurse leja e ndërtimit duhet të kërkohet sipas ligjeve të cilat janë në fuqi dhe duhet t'I plotësojnë kriteret. Ajo atëherë ishte thënë dicka tjetër deri sa tani po vërej se po ndodh dicka tjetër. Sa I përket asaj atëherë ashtu ishte thënë që tokat të cilat janë nën komosacion shkojn sipas një kriteri mbrenda kuvendit që të jipet leja. Atje ku janë zonat për ndërtim duhet të shkojnë sipas këtyre procedurave përmes kuvendit. Duhet t'I plotësoj të gjitha kriteret të ket një komision mbrenda komunës e jo nëse zona ndërtimore a duhet të ndërtohet apo jo.

**Z.VLajkovic:** Kjo nuk ka të bëjë me zonat e ndërtimit ,ka të bëjë me vendin ku njerëzit duan të ndërtojnë është bujqësore. Në mënyrë që dikush të marr leje ndërtimi është e nevojshme të bëhet destinacioni I tokës për këtë kuvendi këtu e lejon lejen e ndërtimit. Leja e ndërtimit dhe ndryshimi i destinacionit merren në bazë të

kritereve dhe ligjeve që ekzistojnë. Kuvendi vetëm I jep pëlqimin departamentit të bujqësisë që mund të bëhet destinimi I pronës,kur në kadastër e marrin sistemin ndrrimin e destinimit të tokës,kur atje nuk ekziston më bujqësore por ndërtimore e atëherë zyrtari I urbanizmit nga ai I cili dëshiron të ndërton kërkon që ti plotësoj të gjitha pikat që janë në ligjin mbi dhënjen e lejes së ndërtimit. Aty është përcaktuar sa duhet që objekti të jet larg nga rruga në mënyrë që të zgjidh problemin e ujërave të zeza dhe një sër pikash,të cilat qytetari duhet t'I plotësoj në mënyrë që të marr lejen e ndërtimit. Kuvendi jep pëlqimin, liron dhe ndihmon Departamentin e Bujqësisë që të bëjë ndryshime në destinacionin e tokës.

**z.Naseri:** Unë e kuptoj ju të saktë, ekziston një komision ku guxojn dhe ku nuk guxojn që qytetarët , sipas ligjit është e përcaktuar 100 m. unë vetëm po them që të mos dalim qesharak sic ësht ënë Viti dhe dhe cdo kund që të shkohet përmes atyre filterave duhet të plotësohen nga secila palë e cila dëshiron të ndërtoj.

**z.Kryetar:** Për këtë qështje cdokush që I plotëson kushtet të gjitha pikat të cilat janë të parapara me ligj e merr lejen. Unë nuk e kam sjell vendimin nga ministria , por mendoj që drejtorët kanë një ndalim vendimtar për çdo ndryshim të destinacionit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Propozimi im është që kuvendi të jap pëlqimin për procedurat e mëtejme ligjore. Këto dy propozime kanë plotësuar të gjitha kushtet e parapara me ligj ose për shembull ai që po ndërton fabrikën ai dyuhet që komunës t'I paguajë 10 mijë euro sikur të mos kishin votuar ju dhe sikur të mos ishte zbatuar procedura ligjore nuk do të paguheshin ato para. Ne gjithashtu kemi një raport të auditimit ku në mënyrë eksplicite kërkojnë që të japim leje dhe të monitoojmë ndërtimet e paligjshme të egra. Becky Rama ka hartuar një projekt të plotë për një muaj, dhe nëse ai merr lejen tuaj ai duhet t'i paguajë të gjitha taksat komunës. Çdo qytetar do të marrë një leje nëse ai ka të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Gjithkush mund të paraqesë kërkesa, por ata duhet të presin për zhvillimin e planit urbanistik. Komuna duhet të ketë të ardhura të taksave në mënyrë që të bëjmë rrugët. Siç tha Naseri se është ndryshe, në Viti unë do të vizitoj dhe do të shoh nëse ka ndonjë mekanizëm lehtësues të komisioneve apo diçka tjetër dhe pastaj do ta bëjmë këtë.

**z.Naseri:** Unë nuk thashë të dalim nga kuadri ligjor dhe nuk mendoj se duhet të shtohet asnjë presje apo pikë e vetme e këtyre rregulloreve ligjore. Nuk ishte e qartë për mua, kam ndërtuar një objekt në zonën kadastrale Kllokot dhe kam dashur të ndërtoj një shtëpi 100 metra mbi shtëpinë. Komisioni erdhi dhe nuk më lejoi të shkoj më shumë se 100 metra ku ishte ndërtimi i zonës. Nuk them se ligjet nuk respektohen, por nuk kemi të bëjmë me procedurat, qytetarët ata duhet të paguajnë taksat dhe të plotësojnë kriteret që janë parashikuar. Sepse unë kam problem ata po më thrrasin mua dhe po më pyesin se si është kjo .

**z.Kryetari:** Vendimi ka qenë I paraparë me ligj. Do ta sjell që ta lexoni të gjithë.

**Znj .Selvije:** Unë mendoj ndryshe, dua të them për zyrën kadastrale se ata duhet të dorëzojnë një listë poseduese në mënyrë që të gjithë delegatët të informohen më mirë, sepse ka edhe një numër, një kopje të planit.

**z.kryesuesi :** Kush është për aprovimin e kësaj pike?

**Konstatoj se pikën e katër e kemi aprovuar me 9 vota për tre delegatë nuk u deklaruan.**

**5. Propozim- vendimi për dhënien e aprovimit të Kuvendit Komunal për zbatimin e procedurës ligjore për ndryshimin e destinacionit të tokës nga bujqësore në ndërtimore në të gjithë ngastrën P-73701026-00262-2 Në emër të parashtruesit të kërkesës Bekim Fehmi Rama Zona Kadastrale Klokot;**

Ne në seancën e fundit I kemi dhënë autorizimin Dorunita Rexhepit që të nënshkruaj bëhet fjalë për Naser Nezirin. Drejtoresah vetëm po prêt që të vërtetohet në mënyrë që ta nënshkruaj vendimin. A dëshiron dikush të thot dicka lidhur me këtë pikë? Kush është që kjo pikë të aprovohet?

**Kosntatoj se me 9 vota për u votua pika e pestë e rendit të ditës.**

**6.Të ndrsyhme;**

**z.Petkovic:Dobar dan svima.** Mirëdita të gjithëve. Sa I përket të gjitha vendimeve të marra që kur jam unë Delegat të gjitha janë respektuar,zotëri kryetar cka u bë me pastrimin e rrugëve,rregullimin e rrugëve të hapësirave publike vitin e kaluar cdo gjë ka qenë pastër tani përsëri është kthyer në papastërti ne tani për 10 ditë e kemi festën që dalim në varreza as ajo nuk është e rregulluar. Unë do të doja të referohen në qytetin e Kllokotit, ku është selia e komunës ne kemi votuar, ne e kemi ndërtuar atë të gjitha qëndrojn. Por e gjitha kjo duhet të mirëmbahet.trotuaret në Kllokoy kanalizimi nuk funksionon kemi shtratin e lumit e cila është e kapacitetit të vogël por kur ka të reshura,aty afët është sh.f. Sveti Sava duhet që të pastrohet në mënyrë që ato të reshura të kalojnë e jot ë mbetet tek shkolla ku fëmijët e thithin ajrin e po ashtu edhe banorët e Kllokotit. Njejt edhe për Planin e sigurisë nuk e keni cekur për pastrim. Kur kalojmë rrugës nga Mogilla nga bari nuk shofim për të vozitur,vitin e kaluar është pastruar kurse këtë vit asgjë. Unë në disa dyer kam trokitur që hyrja në Kllokot është mjaft e rrezikshme që pjesëmarrësit në komunikacion vozisin aq shpejt saqë është e pamundur,e më së shumti kur të vijn mërgimtarët kur I kan pushmet. Që ti finalizojmë gjërat cka është duke ndodhur me kositjen, po në lidhje me rendin e trafikut finalizimin e Kllokotit, rregullimi i rrjetit të kanalizimit në Kllokot dhe kam kërkuar pastrimim e shtratit të lumit në afërsi të shkollës që shkon në rënie.

**znj.Milena:**Përshendetje të gjithëve.,sa I përket vërejtjes së parë të zotëri delegatit Petkovic. Sa I përket hapësirave publike aty duhet më shumë të përfshihen përfaqësuesit e fshatrave të cilët do të angazhohen më shumë,sikurse edhe departamenti im.

**z.Kryetari:** Sa I përket qështjes që po e thot Petkovici unë më së shumti jam I kyqur në të. Në periudhat e ardhshme më shumë o të punojmë në vërejtjet tua.sic e tha Milena që nga përfaqësuesit e fshatrave e deri tek shërbimi ynë do të jenë të kyqur që ajo të përmirësohet. Vitet e kaluara ka patur më shumë pastrime,këtë vit jemi marrë me dicka tjetër. Sa I përket shenjave të komunikacionit dje kemi punuar në projekt. Do të jetë te Rera com vendkalimi për këmbësor në dy ngjyra si dhe tek Kalaja dhe furra dhe në hyrje të Kllokotit,në Mogillë tek shkolla Gjin Serreqi,rruga kur kthehesh tek shkolla e vjetër,po ashtu edhe në Vërbovc do të jetë me dy ngjyra tek Car Llazari ku kalojnë fëmijët e Gërnqarit. Aty na ka ndihmuar komandanti nga Vitia. Nëse keni edhe ndonjë propozim mund të ja ipni Milenës. Në lidhje me një ndihmë momentale që ka qenë në seancën e kaluar puntori I cili punon në atë drejtim Tanja Nisic ajo për këtë do të jap informata.

**Znj.Tanja Nisic:** Përshëndes të gjithë të pranishmit,sic e tha kryetari unë jam kryetare e komisionit për ndarjen e një ndihme momentale. Janë edhe katër anëtar të komisionit.Lista për vitin 2017 e një ndihme momentale janë lejuar 148 këkrkesa të palëve dhe atë 142 kërkesa për familjet serbe dhe 6 të familjeve shqiptare. Për vitin 2019 lista e ndihmës momentale janë lejuar 37 kërkesa dhe atë 30 serb dhe 7 shqiptarëve. Gjë që kjart mund të shifet që tani është gjendja reale në krahasim me vitin 2017. Ua të them për këto 37 kërkesa kjo është për 5 muaj, do të ketë ende ndarje në vitin 2019.

z.**Hidajeti:**A e keni listën për vitin 2018?

z.Kryetari : Do ta sjellim në seancën e radhës. Kurse e pat që prej 148 shfrytëzuesve,28 mijë euro janë shpenzuar në vitin 2017 ju të gjithë mund të vini dhe të shihni se kush ka marër ndihmë momentale. Unë nuk e fajësoj Hidajetin sepse ai atë kohë ka qenë drejtor I administratës për këtë vendos Kryetari,deshta vetëm që ta shihni dh eta bëni dallimin e vitit 2017 dhe tani vitit 2019.

**z..H**idajeti : Ka pasur shumë polemika në seancën e kaluar dy ose tre herë kam bërë një kërkesë për qasje në dokumente publike për listën e fituesve të ndihmës momentale një herë për vitin 2018. Në këtë rast, unë nuk fajësoj komisionin. Secili kryetar i komunës e përdor komisionin formalisht pavarësisht nëse komisioni është ekspert apo jo. Unë nuk fajësoj as drejtorët sepse vulë për të gjitha është kryetari.

**z.Shqiprimi:** Kryesuesi i Komisionit për Komunitete është shumë ngarkuar, sepse vendimet që bijmë në atë seancë nuk i kalojnë asamblesë, a nuk keni bashkëpunim, mos komunikim dhe pse këto vendime nuk vijnë në rend të ditës në asamble, sikur të na largoni me ato vendime.

**Kryesuesi :** Për ju është e njohur ne ne nuk bojkotojmë asgjë, kryetari i komunitetit duhet të dorëzojë kuvendin dhe ne do ta vendosim atë në agjendë. Dje ishin disa nga një organizate e komunitetit shqiptar, askush nuk ishte i pranishëm. Kërkova një shkollë në Kllokot për fëmijët shqiptarë.

**Znj..Selvije**: Unë dua të plotësoj bashkëbiseduesin e mëparshëm i cili kërkoi pastrimin e hapësirave publike, do të ketë edhe 10 punëtorë shtesë duke filluar nga e hëna. Ata do të duhet të punojnë si ndihmës për punëtorët tanë në mënyrë që ata të paguhen. Është mirë kur ju keni vërejtje që I sjellni këtu për të punuar së bashku për të zgjidhur. Falenderoj kryetarin për fjalët e mira,në mënyrë që puna ime të jetë më efikase ju lutem kryetar nëse tani po flitet për buxhet zyra ime duhet të ketë buxhet për shkak se e keni parë që unë komunën e shof të përbashkët për këtë kërkoj që të ndahet buxheti sepse kam detyrime për komunitetin tim,sepse komuniteti im ka nevojë për motivim edhe për përkrahjen tonë dhe të lutem të gjejsh mënyrën sepse e zyrës sime I takom ligjërisht buxheti.

**Kryetari** : Ne do të punojmë në atë drejtim se sit ë sigurojmë mjete për nënkryetaren e komuniteteve sepse ligjërisht buxheti I takon. E ftoj drejtorin e kadastrit dhe bujqësisë të fillojnë me punën lidhje me dokumentet me njerëzit të cilët sot kan marrë lejet e ndërtimit dhe të paguajnë të gjitha taksat dhe të zbatohet deri në fund. Po ashtu edhe drejtoreshën e administratës dhe shëndetësisë që të organizohen rreth pastrimit të hapësirave publike.

**Në fund kryesuesi e mbylli seancën e pestë të rregullt të Kuvendit komunal Kllokot-Vërbovc për vitin 2019.**

Datë: **31.05.2019**

Kryesuesi I kuvendit komunal Kllokot-Vërbovc

/Zarko Dejanovic/